




KËSHILLI I QARKUT BERAT

PLAN BUXHETI

VITI 2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT BERAT

MESAZHI PER PROJEKT-BUXHETIN E VITIT 2022

Lënda: Projekt - Buxheti i Këshillit të Qarkut Berat për vitin 2022 .

Anëtarëve të Këshillit të Qarkut Berat

Të nderuar zonja dhe zotërinj Këshilltarë të Qarkut Berat,
Në emër të administratës së Këshillit të Qarkut, është nder të prezantoj Projekt-Buxhetin për vitin 2022.

I. Pamje e përgjithshme

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Institucionit të Këshillit të Qarkut, bazohet në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin Nr . 115, Datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Udhëzimi Nr. ____ datë _____ "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022"

Këshilli i Qarkut Berat harton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, i cili krijohet në mënyrën e parashikuar me ligj, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Buxheti vendor është unik dhe i balancuar. Në këtë projekt buxhet do të pasqyrohen të gjitha burimet e financimit dhe shpenzimet të cilat janë parashikuar duke pasur si objektiv rritjen e standardeve dhe cilësinë e shërbimeve, paralelisht me rritjen e efikasitetit në menaxhimin e shpenzimeve.

Projekt Buxheti i vitit ushtrimor 2022 është hartuar bazuar në :

- Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, me përfshirjen në këtë proces të gjithë strukturave përgjegjëse të aparatit të institucionit si dhe të ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore të Këshillit të Qarkut Berat .
- Në udhëzimin Nr.7, datë 28.2.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm"
- Funksionet që përcakton Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në strukturat buxhetore të programeve të përcaktuara nga Ministria e Financave .

Qëllimi kryesor i programeve është integrimi dhe standardizimi me legjislacionin si parim bazë në zhvillimin e qëndrueshmërisë në rajon, përmirësimin e cilësisë së jetës në njësitë e pushtetit vendor.

Politikat e institucionit të Këshillit të Qarkut në planifikimin dhe menaxhimin e shpenzimeve buxhetore në vitin 2022 synojnë:

- Uljen e shpenzimeve të kostos së personelit .
- Uljen e shpenzimeve operative të administratës .
- Transparencë të plotë në përdorimin e fondeve publike .
- Rritjen e efikasitetit në administrimin e fondeve .

-Rritjen e fondeve për investime nëpërmjet grantit, të ardhurave dhe financimeve të huaja.

Parashikimi i projekt-buxhetit për vitin financiar 2022 përbën bazën e planifikimit të Projekt-Buxhetit Afatmesëm dhe shërben si orientim lidhur me prioritetet që përcaktohen në PBA 2022-2024.

Ky orientim përcakton rrjedhën e ecurisë, si në drejtim të rritjes së të ardhurave, ashtu dhe në përdorimin, menaxhimin dhe shpenzimin me efektivitet të tyre .

Është e vlefshme të theksojmë se në gjithë këtë punë të bërë nga specialistët përkatës, janë respektuar mendimet nga aktorë të tjerë të interesit, për të hartuar një projekt sa më real dhe të besueshëm, duke shfaqur dukuri dhe fenomene pozitive.

Baza e hartimit të projekt-buxhetit është ecuria e buxhetit të vitit 2021, si dhe ecuria në vitet e mëparëshme,

Ky buxhet është hartuar mbi bazën ligjore si vijon:

a) Ligji Nr.139 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*"

Neni 8 ku përcakton ushtrimin e autoritetit me interes publik.

Neni 38, pika 3 ku përcakton se një nga burimet e financimit të Qarkut është edhe Kuota e antarësisë së Bashkive përkatëse të përcaktuara edhe në buxhetin vjetor të vetë bashkive. Kuota e antarësisë për financimin e buxhetit të Qarkut përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak.

Neni 72 ku përcakton se anëtarët e Këshillit të Qarkut e kryejnë funksion pa shpërblim me përjashtim të anëtarëve të Kryesisë të Këshillit të Qarkut.

Neni 41 ku përcakton parimet kryesore për hartimin e buxhetit lokal, si "*Buxheti duhet të jetë gjithmonë i balancuar, të përfshijë elemente të shpenzimeve dhe të ardhurave, transfertat e kushtëzuara të përdoren vetëm për qëllimin e dhënë dhe nuk trashëgohen për vitin pasardhës*"; *Të ardhurat vendore që nuk janë të kushtëzuara të përdoren për qëllime që përcaktohen nga organi vendimmarrës dhe trashëgohen në rast se nuk harxhohen.*

b) Ligji Nr.9936 datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" me ndryshimet e bëra ,

c) Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022 është bërë në zbatim të Ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 38, pika 2 gërma a,b,c,ç dhe pika 3.

ç) Llogaritja e pagave është bërë në zbatim të VKM Nr.177 date 08.03.2017 "*Për klasifikimin e funksionit, grupimin e njësisve të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave për punonjësit e organeve të vetëqeverisjes vendore*"

d) Llogaritja e sigurimeve shoqërore është bërë në bazë të VKM Nr.700 datë 18.06.2009 "*Për disa ndryshime në VKM Nr.167 datë 29.03.2006*" "*Për disa çështje në zbatim të ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"* ndryshuar me ligjin Nr.7870 datë 13.10.1994 "*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar.*

e) Shpenzimet për dietat, hotel, transport janë bërë sipas VKM Nr.1198 datë 13.12.2009 për disa ndryshime në VKM Nr. 228 datë 13.04.2001 "*Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre*" e ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 997 datë 10.12.2010 "*Për punonjësit që dërgohen me shërbim jashtë shtetit ndryshuar me VKM Nr. 870 datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit"* si dhe Udhëzimit Nr.22 datë 10.07.2013 të Këshillit të Ministrave për trajtimin financiar të punonjësve, VKM Nr. 66

datë 07.02.2007 mbi ndryshimin e vlerave të transportit të udhëtarëve. VKM Nr.329, datë 20.04.2016 "Për disa ndryshime në VKM Nr. Nr. 997 datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit.

f) Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

g) VKM Nr.277 datë 18.06.1997 e ndryshuar me VKM Nr.34, datë 19.01.2011 " Për përfitimet nga statusi i të verbërit", pika 12 " Masa e financimit për Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë përcaktohet nga Ministria e Financave, kurse për degët e saj në rrethe nga Këshillat e Qarqeve përkatëse"

II.TË ARDHURAT

PËRMBAJTJA E TOTALIT TË TË ARDHURAVE DHE BURIMEVE TË FINANCIMIT

- a. Transferta e pakushtëzuar
- b. Transferta e kushtëzuar
- b. Të ardhurat nga shërbimet e veta
- c. Të ardhurat nga kontributet e Bashkive pjesë përbërëse të Qarkut
- d. Mundësitë e financimeve të huaja për investime.

Për vitin 2022, burimi kryesor i të ardhurave mbetet transferta e pakushtëzuar për të përballuar shpenzimet .

III.SHPENZIMET

Shpenzimet përbëhen nga :

- 1.Shpenzimet për funksionet e veta
 - Administrata vendore
 - Funksioni i deleguar (Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës)
 - Qendra Sociale për të moshuarit "Shtëpia e Përbashkët"

Në planifikimin e shpenzimeve si bazë argumentuese janë :

- 1.Transferta e pakushtëzuar
- 2.Transferta e kushtëzuar
- 3.Të ardhurat e veta të planifikuara për vitin 2022
- 4.Të ardhurat nga kontributet e bashkive.

Në planifikimin e shpenzimeve për investime jemi përqendruar në realizimin e projekteve të fituara si dhe në mbledhjen e të ardhurave që do të derdhen për llogari të Këshillit të Qarkut të gjitha Bashkitë pjesë përbërëse të Qarkut Berat në parashikimin e parafinancimit nga fondet e BE në Kapitullin 2 (financim i huaj) si dhe në rimbursimin e shpenzimeve pas certifikimit të projektit

Të ardhurat dhe shpenzimet janë pasqyruar në mënyre analitike në relacionin për planin e buxhetit për vitin 2022 si dhe në tabelat bashkëlidhur këtij materiali.

Ju faleminderit !





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 1114/19 Prot

Datë 05/01/2022

VENDIM

Nr. 1

Datë 05/01/2022

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT BERAT PËR VITIN
2022 dhe PBA PËRFUNDIMTARE 2022-2024

Këshilli i Qarkut Berat pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga grupi i punës për hartimin e Projekt Buxhetit të Këshillit të Qarkut Berat për vitin 2022, mbështetur në kuadrin ligjor mbi procesin e buxhetimit vendor si më poshtë :

- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 40
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; neni 8, pika 2 ,neni 9 pika 1.1, b, neni 31 pika 1,2,3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41, neni 72 pika 5, neni 77 pika dh, neni 83, pika ç.
- Ligji Nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 10/1 i vitit 2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor.”
- Ligje dhe akte nën ligjore të tjera.

VENDOSI:

Të miratojë të ardhurat dhe shpenzimet si më poshtë (në lekë):

I.TË ARDHURA GJITHSEJ	37 659 000
1. Të ardhurat e veta	
a) Grant i pakushtëzuar viti 2022	34.159.000
b) Të ardhura nga Bashkitë	3.000.000
c) Të ardhura nga Shërbimet	500.000

II.SHPENZIME GJITHSEJ SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT

Tabela permbledhese e buxhetit te vitit 2022 sipas burimeve te financimit

Nga granti i Pakushtezuar 2022			
Lloji i shpenzimit	Llogaria	Shuma leke	Ne mije leke
Shpenzime per paga	600	16,700,000	16,700
Shpenzime per sigurime shoqerore	601	2,643,000	2,643
Shpenzime operative	602	8,275,000	8,275
Transferta (Shoqata e Qarqeve)	602	500,000	500
Transferta(AER)	602	400,000	400
Investime	231	5,566,000	5566
TOTALI i Shpenzimeve nga Granti i pakushtezuar		34,159,000	34,159
Te ardhurat 2022			
Investime	231	460,000	460
Qendra e të moshuarve	600	1,341,000	1341
Qendra e të moshuarve	601	222,000	222
Qendra e të moshuarve	602	1,000,000	1000
Transferta (Te Verberit)	602	100,000	100
Fondi Rezerve	602	377,000	377
TOTALI i shpenzimeve nga te ardhurat e 2022		3,500,000	3,500
Total buxheti		37,659,000	37,659

2. Shpenzimet do të përdoren sipas pasqyrave bashkëngjitur këtij projekt vendimi.
3. Kryetari i Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë transferimin e fondeve operative pa limit për artikujt e miratuar nga Këshilli i Qarkut.
4. Përgjegjësi i Sektorit të Financës autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli i Qarkut sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave për çdo muaj.

KRYETAR
Donald MOLISHTI



Këshilltarë gjithsej : 18

Morën pjesë : 10

Votuan pro : 10

INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022

Të nderuar Këshilltarë

Projekt-Buxheti i paraqitur përpara jush për vitin 2022 është parashikimi i dy komponentëve kryesorë të një buxheti:

I. Parashikim i të ardhurave vendore

II. Parashikim i shpenzimeve për vitin 2022 nëpërmjet të cilave synohet promovimi i vizionit që ka Këshilli i Qarkut

- Procesi i hartimit të projekt buxhetit për vitin 2022 përbën një komponent shumë të rëndësishëm në kuadër të ciklit të menaxhimit financiar, pasi nëpërmjet këtij projekt buxheti synohet realizimi i aspekteve kryesore të vizionit dhe detyrimeve ligjore që qeverisja vendore në nivel qarku mund dhe duhet të përmbushë.
- Këshilli i Qarkut Berat ka për qëllim të ndërtojë politika nxitëse dhe të promovojë një vizion të ri, duke mbështetur iniciativat e reja
- Qëllimi ynë është detajimi i një buxheti sa më real për përdorimin e të ardhurave në realizimin e shërbimeve, projekteve, funksionimin e administratës si dhe koordinimin e punës me bashkitë që janë në juridiksionin e këtij qarku.
- Prioriteti në këtë projekt buxhet i është dhënë :
Drejtimit të programit dhe përmirësimit analitik të zërave të buxhetit duke e detajuar zë më zë. Menaxhimit dhe monitorimit të vazhdueshëm të shpenzimeve në raport me realizimin e të ardhurave
- Projekt Buxheti duke qene modest në shifrat e tij synon në radhë të parë të ndërtojë politika nxitëse dhe të promovojë një vizion të ri për të gjitha bashkitë të cilat janë pjesë përbërëse e territorit të qarkut tonë. Karakteristike e tij është të promovojë vlera e të japë kontributin e tij në bashkëfinancimin me projektet e BE, me qëllim që të ndihet roli i Qarkut në formë sa më gjithëpërfshirëse.

Buxheti i Këshillit të Qarkut shoqërohet me :

- Misionin apo qëllimin e njësisë vendore
- Përshkrimin e programeve dhe veprimtarinë e kësaj njësie
- Paraqitjen e politikave, të qëllimeve dhe objektivave të politikës së programeve
- Standartet e politikave
- Shpenzimet kapitale, projekte etj.

Buxheti i miratuar nga Këshilli i Qarkut Depozitohet në degën e Thesarit në përputhje me rregullat dhe formatet e kërkuara për regjistrimin në sistemin AMOFTS.

Buxheti vendor është unik, të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten sipas shërbimeve dhe zërave:

Plani vjetor i Buxhetit të Këshillit të Qarkut akordohet në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, duke përfaqësuar limitin maksimal të lejuar për tu shpenzuar nga Qarku.

PROCEDURAT E DETAJIMIT TË PLANIT BUXHETOR

Buxheti i Qarkut për vitin 2022 përbëhet nga të ardhurat e veta që krijon njësi shpenzuese dhe nga pjesa e grantit të kushtëzuar e të pakushtëzuar të akorduar nga niveli qendror i cili miratohet në këshill. Në zbatim të ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" me ndryshimet e pësura, për të gjitha njësitë shpenzuese është e detyruar përgatitja e buxhetit sipas programeve. Për efekt të ndjekjes së buxhetit në funksion të menaxhimit të likuiditeteve njësitë shpenzuese duhet të detajojnë në periudha mujore dhe të ndara në dy grupe:

Shpenzime të personelit
Shpenzime të tjera (ku përfshihen shpenzime korrente dhe kapitale)

Treguesit kryesorë të buxhetit të vitit 2022

1. TË ARDHURAT

Burimet kryesore të të ardhurave janë granti i pakushtëzuar nga buxheti i shtetit, të ardhurat nga bashkitë dhe të ardhurat nga shërbimet e veta (DAMT)

Totali i të ardhurave buxhetore për vitin 2022 është parashikuar në nivelin rreth 37 659 në mijë lekë pa përfshirë grantin e trasheguar nga viti 2021, të ardhurat e trasheguara nga viti 2021 si dhe transfertat për funksionet e deleguara, transfertën për Qendrën Sociale si dhe pa përfshirë transfertat nga BE në kapitullin 02 për projektet e huaja si parafinancim ose disbursim pas certifikimit të një projekti.

Sipas zërave kryesor të të ardhurave situata paraqitet si vijon (në mijë leke)

Total 37659

a) Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar	34159
b) Të ardhura nga shërbimet e veta (DAMT)	500
c) Të ardhura nga kontributi i Bashkive	3000

Parashikimi i të ardhurave për vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar rritje pasi:

Duke krahasuar planin me faktin e vitit 2021 vihet re realizimi mbi 100% i të ardhurave nga shërbimet e veta. Gjithashtu treguesi kryesor në parashikimin e të ardhurave është kuota e antarësisë së bashkive përbërëse në nivel Qarku sipas përcaktimeve të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 38, pika 3 (Qarku financohet nga kuota e antarësisë së bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të bashkive.) Duke u mbështetur në realizimin e derdhjes së kontributeve në vitin 2021, për vitin 2022 është bërë parashikimi i të ardhurave pothuajse në të njëjtin nivel me vitin e mëparshëm i cili nivelin e të ardhurave të parashikuara e kishte 3000 mijë lekë plan dhe 1779.6 mijë lekë fakt pra 59 %.

Për vitin 2022 është shumë i domosdoshëm realizimi i të ardhurave sipas parashikimeve pasi është parashikuar të finalizohen 3 projekte strategjike të fituara të cilat kapin një shifër të konsiderueshme në buxhet dhe janë projekte nëpërmjet të cilave përfitojnë edhe vetë Bashkitë përbërëse të Qarkut dhe bashkëfinancimi ndërmjet Qarkut dhe BE është kusht kryesor i kontratës. Pra është domosdoshmëri përmbushja e detyrimit ligjor për derdhjen e kuotës së antarësisë nga ana e bashkive dhe kjo e ardhur të derdhet sipas përqindjes së miratuar në këshillat përkatës të bashkive duke qenë se është një nga të ardhurat kryesore e cila ndikon drejtpërdrejt në realizimin e buxhetit të qarkut për sa i përket investimeve.

2. SHPENZIMET

Totali i shpenzimeve është parashikuar në 37 659 mijë lekë pa përfshirë grantin dhe të ardhurat e trashëguara si dhe transfertën e kushtëzuar.

Ky buxhet mbart detyrime nga viti i kaluar (Shpërblim i këshilltarëve, investime, shpenzime të tjera operative, vendime gjyqësore).

Karakteristikat kryesore të shpenzimeve korrente dhe kapitale në buxhetin e vitit 2022 janë si vijon:

- Shpenzime për personelin
Numri i personelit administrativ do të jetë 10 dhe 3 të zgjedhur. Gjithsej 13. Pra fondi i shpenzimeve për personelin (Paga e Sigurime), fondi i vecantë 5% për vitin 2021 është

llogaritur për 13 punonjës në total planifikuar 19343 ose 40 % e buxhetit pa funksionet e deleguara.

- *Shpenzimet operative* ku përfshihen (Materiale për funksionimin e zyrave, Vendime Gjyqësore, shpërblim i këshilltarëve, mirëmbajtje, etj) për vitin 2022 janë parashikuar në vlerën 8275 mijë lekë ose 22 % e buxhetit total.
- *Shpërblimi i këshilltarëve* duke përfshirë edhe detyrimin e prapambetur nga viti 2021 është në vlerën 975 mijë leke ose 0.08%
Grupi i punës duke pasur parasysh situatën financiare të të ardhurave ka parashikuar shpenzimet në të njëjtin nivel me vitin e kaluar duke kryer vetëm shpenzimet më të domosdoshme për funksionimin e administratës duke ju dhënë prioritet investimeve dhe bashkëfinancimit të projekteve strategjike të fituara nga BE.
- Është parashikuar edhe shlyerja e *detyrimeve të prapambetura* nga vitet e kaluara.
- *Shpenzime gjyqësore*
Në buxhet është planifikuar shlyerja e vendimeve gjyqësore në masën 2200 mijë lekë nga granti i vitit 2022 pas propozimeve të këshilltarëve pasi shuma që ishte parashikuar zinte 49 % të totalit të shpenzimeve operative. Shprehur në përqindje ndaj totalit të shpenzimeve operative kjo shumë zë 26 %. Detyrimi total çdo muaj shtohet pasi vendimet janë me rikthim në vendin e mëparshëm të punës.
Për shlyerjen e vendimeve Këshilli i Qarkut procedon sipas udhëzimit në fuqi për shlyerjen e Vendimeve Gjyqësore.
- *Transferta kundrejt Asamblese Europiane të Rajoneve* ku Këshilli I Qarkut Berat bën pjesë është në shumën 400 mijë lekë,
- *Transferta kundrejt Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë* është parashikuar në shumën 500 mijë lekë.
- *Transferta për financimin e Shoqatës së të Verbërve* do të jetë në masën 100 mijë lekë.
- *Shpenzimet për investime* arrijnë në vlerën 6 026 mijë lekë.
- *Shpenzime për pagesën e punës së kryer nga punonjësit dhe të shërbimit catering të ofruar pranë Qendrës Sociale për të moshuarit “Shtëpia e Përbashkët”* në shumën 2563 mijë lekë. Ky fond do të përdoret për shpenzimet e sipërcituara në rastin e mbylljes së Projektit “Shtëpia e Përbashkët” nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pa njoftim paraprak.

REFERENCA LIGJORE MBI TË CILËN ËSHTË HARTUAR BUXHETI I VITIT 2021

I. Ligji Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Neni 8 i cili përcakton ushtrimin e autoritetit me interes publik;

Neni 38 pika 3 ku përcakton se një nga burimet e financimit të Qarkut është edhe Kuota e antarësisë së Bashkive përkatëse të përcaktuara edhe në buxhetin vjetor të vetë bashkive. Kuota e antarësisë për financimin e buxhetit të Qarkut përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak;

Neni 72 ku përcakton se anëtarët e Këshillit të Qarkut kryejnë funksionin pa shpërblim me përjashtim të anëtarëve të Kryesisë të Këshillit të Qarkut;

Neni 41 ku përcakton parimet kryesore për hartimin e buxhetit lokal, si "Buxheti duhet të jetë gjithmonë i balancuar, të përfshijë elemente të shpenzimeve dhe të ardhurave, transfertat e kushtëzuara të përdoren vetëm për qëllimin e dhënë dhe nuk trashëgohen për vitin pasardhës"; Të ardhurat vendore që nuk janë të kushtëzuara të përdoren për qëllime që përcaktohen nga organi vendimmarrës dhe trashëgohen në rast se nuk harxhohen.

II. Ligji 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" me ndryshimet e bëra ,

III. Planifikimi i të ardhurave për vitin 2021 është bërë në zbatim të Ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 38, pika 2 gërma a,b,c,ç dhe pika 3.

- IV. Llogaritja e pagave është bërë në zbatim të VKM Nr.177 date 08.03.2017 "Për klasifikimin e funksionit, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave per punonjësit e organeve të vetëqeverisjes vendore"
- V. Llogaritja e sigurimeve shoqërore është bërë në bazë të VKM Nr.700 datë 18.06.2009 " Për disa ndryshime në VKM Nr.167 datë 29.03.2006" "Për disa çështje në zbatim të ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar me ligjin Nr.7870 datë 13.10.1994 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar.
- VI. Shpenzimet për dietat, hotel, transport janë bërë sipas VKM Nr.1198 datë 13.12.2009 për disa ndryshime në VKM Nr. 228 datë 13.04.2001 "Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre me ndryshime", si dhe Vendimit Nr. 997 datë 10.12.2010 "Për punonjësit që dërgohen me shërbim jashtë shtetit ndryshuar me VKM Nr. 870 datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit" si dhe udhëzimit Nr.22 datë 10.07.2013 të këshillit të ministrave për trajtimin financiar të punonjësve, VKM Nr. 66 datë 07.02.2007 mbi ndryshimin e vlerave të transportit të udhëtarëve.
- VII. Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
- VIII. Për të gjitha shpenzimet e tjera grupi i punës është mbështetur në ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" me ndryshimet e bëra.
- IX. Ligji nr.162/2020 "Për prokurimin publik", neni 85.


Grupi i punës

KESHILLI I QARKUT BERAT

BUXHETI I PERGJITHSHEM I KESHILLIT TE QARKUT PER VITIN 2022
ne 000/ leke


TE ARDHURA			SHPENZIME		
Nr.	Burimet e Financimit	Plani 2022	Nr.	Funksionet	Plani 2022
1	Transfertat	34159	1	Funksionet e veta	27618
	Transferta e pakushtëzuar	34159		a. Administrata e Këshillit të Qarkut	16700
				Paga Administrata	2643
				Sigurime shoqërore e shëndetsore	8275
2	Të ardhurat	3500		Shpen. operative, vendime gjyqësore	975
	Kont.financiar bashki viti 2022	3000		b. Shpërblim per Kryesine e K.Qarkut	975
	Të ardhurat e veta	500		Për anetarët e Kryesisë Këshillit Qarkut	0
				c. Investimet	0
				Administrata e Këshillit të Qarkut	9066
			2	Programet të tjera	6026
				- Bashkëfinancimi në Projektet e BE	
					1060
				b. Projekti "Tactical Tourism"	4400
				c. Projekti "Waste Rreact"	566
				d. Projekti "Sus Turismo"	2663
				Projekte te tjera	100
				Shoqata e të verbërve	2563
				Qendra Sociale "Shtëpia e Përbashkët"	
			3	Fond rezervë	377
	TOTALI TË ARDHURA	37,659		TOTALI SHPENZIME	37,659

P/Sektorit te Finances
Esmeralda METAJ




Keshilli i Qarkut Berat		(000)leke	
Plani i te ardhurave per vitin 2022			
Nr	Emertimi i te ardhurave	Realizimi i pritshem I vitit 2021	Plani per vitin 2022
	Keshilli i Qarkut		
1	Leje ndertimi		
2	Sherbimet	360,000	500
3	Dokumenta tenderi		
4	Leje trasporti		
5	25% shitjes se truallit		
	Bashkia Berat	-	1,000
7	Taks automjeti		
8	Taks vendore		
9	25%Shitje trualli		
10	Tatim I thjeshtuar		
11	Te tjera te pushtetit vendor		
	Bashkia Kucove	1,682,458	500
12	Bashkia Ura Vajgurore	-	500
13	Takse vendore		
14	Shitje trualli		
15	Tatim I thjeshtuar		
16	Te tjera te pushtetit vendor		
	Bashkia Skrapar	97,205	500
17	Bashkia Polican	-	500
18	Tatim I thjeshtuar		
19	Taks vendore		
20	Shitje trualli		
21	Te tjera tatime te pushtetit vendor		
	Totali	2,139,663	3,500

P/SEKTORIT TE FINANCES
Esmeralda METAJ



KESHILLI I QARKUT BERAT
SEKTORI I FINANCES ZHVILLIMIT RAJONAL E INVESTIMEVE

ne 000/leke

TABELA E LLOGARITJES SE SHPENZIMEVE PER VITIN 2022

Nr.	Emeritimi shpenzimit	Nr. punonjës	F. Paga	Sigurim	Total paga sig. shoc	Shpen.op. vend.gjyqi	Keshilltare	Investime	Projekte fond BE	Projekte te tjera (Qendra	Shoqata verber	Fond rezerve	Buxheti total
	Plan buxheti viti 2020												
a	Administrata K. Qarkut	13	16,700	2,643	19,343	8,275	900	-	6,026	2,563	100	377	37,584
b	Detyrime trasheguara						75			-			75
	TOTAL BUXHETI	13	16,700	2,643	19,343	8,275	975	-	6,026	2,563	100	377	37,659
	Ne % ndaj totalit		44.35	7.02	51.36	21.97	2.59	-	16.00	6.81	0.27	1.00	100.00

P/SEKTORIT TE FINANCES
Esmeralda METAJ

Esmeralda METAJ



Keshilli i Qarkut Berat

Pasqyra e shperndarjes sipas muajve per te ardhurat e vitit dhe grantin e pakushtezuar 2022

(000) leke

Nr tura	Stuk	Lloji te ardhrave	Shuma	Muajt											DH
				J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	
1		Grant i pakushtezuar	34159	5000	3500	1748	3040	2800	2700	2757	2600	2500	3515	2000	2000
4		Te ardhurat e vitit ushtrimor 2021	3500	100	300	300	300	300	400	300	300	300	300	300	300
		Total	37659	5100	3800	2047.7	3340	3100	3100	3057	2900	2800	3815	2300	2300

P/SEKTORIT TE FINANCES
Esmeralda METAJ




Llogaritja e shperblimit te keshilltareve per vitin 2022


Emertimi	Nr	Baza e shperblimit	Leke ne muaj	Periudha ne muaj	Shuma vjetore
Anetare Kryesie	5	15,000	75,000	12	900,000
DETYRIM 2021	5	15,000	75,000	1	75,000
TOTALI					975,000

P/SEKTORIT TE FINANCES
Esmeralda METAJ



KRYETAR
Donatë MOJQISHI





KËSHILLI I QARKUT BERAT

**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
2022 - 2024**

Përmbajtja

1. HYRJE	4
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR	4
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	6
2. BUXHETI AFATMESËM I QARKUT BERAT 2022-2024	8
2.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË QARKUT BERAT NË VITET 2022-2024	9
2.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Qarkut BERAT për vitet 2022-2024	9
2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Qarkut Berat për periudhën 2022-2024	12
2.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR	
3. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE.....	13
4. BUXHETI VJETOR	14
5. SHTOJCAT	

Lista e Tabelave

<i>Tabela 1. Të dhëna mbi Qarkun BERAT.....</i>	8
---	----------

Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MFE	– Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto

1. HYRJJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësinë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësinë vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të Kwshillit të Qarkut Berat;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjat' i referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së . Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"

brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2022-2024 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanëve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT) dhe Formatet e reja për planifikimin e shpenzimeve të programit.

